

**Ministria për Fëmijët, Familjen, Refugjatët
dhe Integrimin e Landit të Nordrhein-
Westfalen**

11.12.2020

Informacion për prindërit,

të cilët çojnë fëmijët në qendrat e kujdesit ditor ose në kujdesin e dedikuar për fëmijë

**Informacion për furnitorët, menaxhmentin,
personelin e**

qendrave të kujdesit ditor dhe kujdesin e dedikuar të fëmijëve

Lockdown nga data 14.12.2020 deri më 10.01.2021

Pandemia për shkak të Korona virusit ka një dinamikë që na detyron vazhdimisht të veprojmë me një njoftim të shkurtër në kohë. Ky është një rast i tillë. Ri-shpërthimi i infeksioneve dhe situata e tensionuar në njësitë e kujdesit intensiv, e bëjnë këtë njoftim të nevojshëm. Jeta shoqërore duhet të ulet sa më shumë që të jetë e mundur. Edhe qendrat e kujdesit ditor për fëmijët mund të japin një kontribut për këtë.

Për periudhën nga data 14 dhjetor deri më 10 janar 2021 është i vlefshëm informacioni i mëposhtëm:

- Do të zbatohen oraret e planifikuara të mbylljes
- Përtej kësaj, qendrat e shërbimit të kujdesit ditor për fëmijët do të qëndrojnë të hapura, pra nuk do të jenë të mbyllura (si në pranverë)

- Garancia e kujdesit zbatohet për: Fëmijët, të cilët e kanë të domosdoshme pjesëmarrjen në shërbimin e kujdesit ditor për fëmijët, do të marrin shërbimin e kujdesit.
- Kur prindërit kanë nevojë për ndihmë dhe kujdes, do e marrin këtë shërbim. Kjo vlen shprehimisht edhe për arsye private. Asnjë fëmijë nuk duhet të dëmtohet nga ky lockdown. Kërkoni një kontakt të besueshëm në qendrën tuaj të kujdesit ditor ose punonjësin e kujdesit ditor për fëmijë.
- Nga data 14 dhjetor 2020 deri më 10 janar 2021, aktiviteti duhet të reduktohet deri në minimum.
- **Prandaj është një thirrje urgjente për të gjithë prindërit që të përdorin këtë shërbim vetëm nëse është absolutisht e nevojshme.** Sezoni i Krishtlindjeve dhe koha midis viteve janë gjithsesi ditë pushimi për shumë familje. Ne i këshillojmë të gjithë prindërit: Përdorni të gjitha opsionet e tjera për të kombinuar punën dhe kujdesin për fëmijët dhe, nëse keni mundësi, mos e sillni fëmijën tuaj në qendrën e kujdesit!

Ministria për Fëmijët, Familjen, Refugjatët dhe Integrimin e Landit të Nordrhein-Westfalen